



Planuar / Ditezuar Prilipen / Pristato Received / Delivered	04.04.2023	3	Viti Year
Organ / Shënia Organ / Shënia Org. Unit	Pr. Prot. Pr. Prot. Prot. No	Shënjë / Përkujtim Appendix	Sasia Kopjime Quantity
SKIMSHK	3299/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.376/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional- ne cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.376/2023 të datës 21.02.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 31.03.2023, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.376/2023 e datës 21.02.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. ref 60/2023, i datës 10.02.2023 i Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datën, 03.10.2022 përmes emalit zyrtar ka njoftuar nëpunësen civile se me datën 08.04.2023 i përfundon marrëdhënia e punës për shkak arritjes së moshës së pensionimit, i cili ka cekur se të njëjtës me rastin e pensionimit sipas nenit 22 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i takon e drejta e kompensimit të një pagë në shumën prej një page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Ndërsa me datën 08.02.2023 Burimet Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes emalit zyrtar nëpunësen e kanë njoftuar se me hyrjen në fuqi të Rregullores

08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik kompensimi i një page me rastin e pensionimit nuk ju takon. Tutje me datën 10.02.2023 Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e



Burimeve Njerëzore ka marr vendimin me Nr.Ref.60/2023 lidhur me përfundimin e marrëdhënies se punës për nëpunësen civile ku sipas këtij vendimi nëpunëses civile i përfundon marrëdhënia e punës me datën 08.04.2023 për shkak të arritjes së moshës gjatë dhjet e pesë vjet (65).

Ankuesja _____ e cila është e sistemuar në pozitën e punës “Zyrtare e Lartë për Kontakte dhe Komunikim”, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e pakënaqur me vendimin me numër Ref.60/2023 të datës 10.02.2023 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme me datën 21.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1941/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimor se dy njoftimet e Burimeve Njerëzore të dërguara përmes emailit zyrtar janë kundërthënëse dhe se konsideron se i është bërë e pa drejtë lidhur me mos kompensimin e një page me rastin e pensionimit si dhe e njëjta kërkon nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës që ti njeh të drejtën e kompensimit të një page shtesë me vlerën e pagës së fundit me rastin e pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 23.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli, me datë 15.03.2023 përmes e-mailit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike; Ankesën me numër të protokollit 1941/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër Reference. 60/2023 të datës 10.02.2023 të lëshuar nga Udhëheqësi i Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Emalin e datës 08.02.2023 të Burimeve Njerëzore të MPJD drejtuar ankueses; Emalin e datës 03.10.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MPJD drejtuar _____ Kërkesën për përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2200/2023 të datës 28.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2374/2023 të datës 06.03.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 06.06.2014; Akt emërimit me numër të protokollit 2139 të datës 13.06.2022; Listën e pagave të muajit Shkurt 2023; Emalin e datës 03.03.2023 të _____ drejtuar KPMSHCK-së;

Nga administrimi i provave të lëndës, të dërguara nga pala dhe nga organi i punësimit Kolegji ka konstatuar se Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datën 10.02.2023 ka marr vendimin me numër Nr. Ref.60/2023 lidhur me njoftim se nëpunësja civile _____ me datën 08.04.2023 i përfundon marrëdhënia e punës pasi që e njëjta arrin moshën e pensionimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve të ankueses ka konstatuar se njoftimi i datës 03.10.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me kompensimin e një pagë përcjellëse me rastin e pensionimit është marr në pajtim me nenin 22 të Ligjit Nr.03/L-147 sepse deri me datën 04.02.2023 ka qenë në fuqi i njëjti ligji ndërsa me datën 05.02.2023 ka hyre në fuqi Ligji Nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik i cili sipas nenit 45 paragrafi 1, dhe 2 i cili ka përcaktuar se 1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil; si dhe paragrafi 2 ka përcaktuar se 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo



katëgorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.

Ndërsa sa i përket pretendimit të ankueses që kompensimi të behet sipas njoftimit të parë të dërguar përmes emalit të datës 03.10.2022 është i pa bazuar sepse neni 35 paragrafi 1, 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, të Ligjit Nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik ka përcaktuar decidivisht se në cilat raste nëpunësi publik mund të kompensohet siç janë përcaktuar, 1. *Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit.* Ndërsa rrjedhimisht i njëjti nuk ka paraparë një kompensim siç pretendon pala ankuese.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me marrjen e vendimit me numër ref.60/2023 të datës 10.02.2023 ka vepruar në pajtim me Ligjit Nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik si dhe Rregullore (QRK) nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, pasi që me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi edhe shtesat dhe kompensimet të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi i pagave Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil,


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.376/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI



Procesmbajtëse

Eshref SHABANI




Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; ;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*